



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-027
Prishtinë, më 26 korrik 2011, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

IMBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 26 KORRIK 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Sasha Milosavleviq dhe Rasim Demiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Bilall Sherifi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 korrik 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjet e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 19 korrik 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 korrik 2011.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjet plenare që do të mbahen më 28 dhe 29 korrik 2011

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi në fund të këtij muaji t'i mbajë dy mbledhje plenare, më 28 dhe 29 korrik 2011:

Më 28 korrik 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Ratifikimi i Marrëveshjes për Llogarinë e Trustit në mes të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës lidhur me ndihmën zhvillimore përmes Programit për arsim themelor,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre,

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zjarrfikje dhe shpëtim,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e informatorëve,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat mbrojtëse të importeve,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizimin sindikal,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kadastrën,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për markat tregtare,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patenta,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve.

Më 29 korrik 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për partneritet publiko - privat,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transmetimin publik në Kosovë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin funksionit publik,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën shtetërore,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për verërat,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe prestarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndihmën juridike falas,
11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin 2010,
12. Propozimi i GP të PDK-së për emërimin e anëtarit në Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim,
13. Propozimi i GP të SLS-së për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
14. Propozimi i GP të Koalicionit Kosova e Re për emërimin e anëtarit në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim - vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.2 Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozim - vendimin e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës që ta shqyrtojë Propozim-vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës lidhur me përcaktimin e përgjegjësiave dhe procedurave të zbarkimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin me rekomandime.

3.3 Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Punë të Jashtme për formimin e Grupit të Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit që ta caktojnë nga një anëtar në Grupin e Miqësisë ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

3.4 Kërkesa e Gjykatës Kushtetuese lidhur me dorëzimin e kopjeve të materialeve të Kuvendit, për nenet e kontestuar të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lartë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që të përgatisë nga një kopje të dokumenteve, sipas kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, dhe përmes Zyrës së Kryetarit të Kuvendit t'i dërgohen Gjykatës.

3.5 Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me projeksionin e shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës, për periudhën korrik-shtator 2011

Pika e cekur më lartë ishte vetëm njoftim për Kryesinë e Kuvendit.

3.6 Njoftimi i Grupit Parlamentar të Partisë së Pavarur Liberale lidhur me vendimin për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Vetëqeverisje Lokale dhe Media

Kryesia u njoftua lidhur me zëvendësimin e anëtarit të Grupit Parlamentar të Partisë së Pavarur Liberale dhe këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për mbledhjen plenare të radhës që do të mbahet më 29 korrik 2011.

3.7 Njoftimi i Grupit Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re mbitërheqjen e deputetes Myzejene Selmani nga Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim

Kryesia u njoftua se deputetja, Myzejene Selmani, është tërhequr nga Komisioni i lartcekur me qëllim që t'ia lirojë këtë vend deputetit nga radha e Grupit Parlamentar të PDK-së. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për emërimin e anëtarit në komisionin e cekur më lartë, është radhitur për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 29 korrik 2011.

3.8 Njoftimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re për emërimin e deputetit Emin Gërbeshi në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të ish-deputetit Ibrahim Makolli

Kryesia u njoftua se deputeti i lartëpërmendur është emëruar nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në vend të ish-deputetit Ibrahim Makolli, dhe këtë pikë të rendit të ditës e radhiti për mbledhjen plenare të radhës, që do të mbahet më 29 korrik 2011.

3.9 Njoftim me Raportin e auditimit e pasqyrave financiare të Administratës së Kuvendit

Kryesia u njoftua lidhur me Raportin e auditimit të pasqyrave financiare nr. 04/637/Ra 055, të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Të ndryshme:

Adem Grabovci, ngriti shqetësimin lidhur me gjendjen e krijuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, me rastin skadimit të mandatit të drejtorit të kësaj Agjencie.

Glauk Konjufca, përshëndeti vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës për vendosjen e rendit dhe të ligjit në pikat doganore 1 dhe 31, si dhe kërkoi që Kuvendi ta mbështesë Qeverinë në zbatimin e këtij vendimi.

Kryetari tha se Kuvendi gjatë këtij muaj do t'i mbajë dy seanca për t'i shqyrtuar projektligjet që janë me prioritet, ndërsa Kuvendi do të shkojë në pushim prej 1 deri më 20 gusht 2011. Seanca e radhës do të jetë më 22 gusht 2011, për të miratuar projektligje që parashihen me Raportin e Komisionit Evropian.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:55** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.